REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS
DREJTORIA LIGJORE

NJOFTIM PËR REZULTATIN E SHPREHJEVE TË INTERESIT

"Për përzgjedhjen e noterit për bashkëpunim në hartimin dhe përgatitjen e akteve noteriale të dhurimit të apartamenteve në kuadër të procesit të rindërtimit"

Në përfundim të afatit të përcaktuar në Ftesën për Shprehje Interesi, të publikuar nga Bashkia Durrës më datë 13.11.2026, me objekt bashkëpunimin për hartimin, përgatitjen dhe nënshkrimin e akteve noteriale të dhurimit të apartamenteve në favor të familjeve përfituese nga programi i rindërtimit, bëjmë me dije se pranë Bashkisë Durrës janë administruar gjithsej 3 (tre) shprehje interesi nga noterë të licencuar.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur dhe analizimit krahasues të ofertave financiare, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Ftesën për Shprehje Interesi dhe legjislacionin në fuqi, rezulton se oferta financiare me vlerën më të ulët, e cila përzgjidhet për bashkëpunim me Bashkinë Durrës në kuadër të procesit të rindërtimit, është paraqitur nga Notere Jonida Spahija, me të dhënat e mëposhtme:

Notere: Jonida Spahija
Adresa: Rruga Aleksandër Goga, Lagjja nr. 11, përballë Gjykatës së Rrethit, Durrës
Nr. tel: +355 69 375 4430
E-mail: jonida_spahija@yahoo.com

Përzgjedhja është kryer duke mbajtur në konsideratë dokumentacionin e paraqitur, ofertën financiare të depozituar dhe përputhshmërinë e saj me tarifat noteriale të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

Bashkia Durrës falenderon të gjithë noterët që shprehën interesin dhe gatishmërinë për bashkëpunim në këtë proces.

DREJTORIA LIGJORE

BASHKIA DURRËS